




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK.nr.449/2022
Datë: 24 nëntor 2022

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 të Ligjit nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Rregullores Nr. 11/2022 për Evidencën Penale në Republikën e Kosovës, në mbledhjen 299-të, të mbajtur me datë 24 nëntor 2022, merr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet vula unike zyrtare për përdorim në certifikatat dhe ekstraktet që pasqyrojnë të dhënat nga dosja penale e të proceduara nga Sistemi Qendror i Evidencës Penale.
- II. Vula në përdorim në këto certifikata, do të jetë vula unike e KGJK-së dhe e njëjta do të përdoret në të gjitha certifikatat/ekstraktet dhe parashtresat e tjera zyrtare të SQEPK-së.
- III. Vula e cila do të përdoret në certifikatat që pasqyrojnë të dhënat nga dosja penale, do të përdoret në bazë të disa rregullave, si në vijim:
 1. Vula zyrtare, e cila do të përdoret në certifikatat/ekstraktet mbi dënimet penale, do të jetë vula e përgjithshëm e Këshillit Gjyqësor të Kosovës.
 2. Kjo vulë do të përdoret si në certifikatat të cilat procedohen fizikisht në gjykata, ashtu edhe në ato të cilat procedohen në formë elektronike (online).
 3. Vula me rastin e printimit të certifikatës, do të gjenerohet automatikisht në certifikatë nga sistemi.
 4. Vula si në pikën 1, do të përdoret edhe në Ekstraktet e gjendjes penale të cilat procedohen nga Zyra qendrore e evidencës penale si dhe në të gjitha parashtresat zyrtare të cilat procedohen nga Sistemi qendror i Evidencës penale.
- IV. Vendimi hyn në fuqi me datë 24 nëntor 2022.

Kopje e vendimit i dërgohet:

- Zyrës Qendrore të Evidencës Penale;
- Sekretariatit të KGJK-së, si dhe
- Arkivit.



Albert ZOGAJ,

Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës